

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar**  
**Financial Accounting**

**P1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 29.09.2018

## CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKCAK-</u> <b>PIKËT E DHËNA</b></b>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

## Problemi 1

Llogaria bankare e Flatra Sh.p.k për muajin Dhjetor 2017 ishte si vijon :

Debi		Llogaria bankare e Flatra Sh.p.k				Kredi	
Data	Pranimet	€	Data	Pagesat	Çeku Nr.	€	
01/12/17	Saldo në fillim	10,263	01/12/17	Tarifat bankare	D.D.	42	
05/12/17	J. Mustafa	2,211	03/12/17	T. Roni	4312	2,213	
10/12/17	T. Fredi	5,373	05/12/17	J. Rian	4313	368	
14/12/17	Depozitim në kesh	534	09/12/17	Energia	D.D.	1,028	
22/12/17	R. Kleon	6,188	13/12/17	T. Moran	4314	618	
29/12/17	Depozitim	4,868	16/12/17	B. Nolan	4315	186	
			19/12/17	T. Monika	S.O.	102	
			22/12/17	J. Ledon	4316	678	
			26/12/17	F. Devon	4317	488	
			29/12/17	J. Rigon	4318	6,884	
			31/12/17	Saldo në fund		16,830	
		<hr/>				<hr/>	
		29,437				29,437	
01/01/18	Saldo në fund	<hr/>				<hr/>	
		16,830					

Më poshtë gjeni deklaratën bankare të “Flatra Sh.p.k” për muajin dhjetor 2017.

**Deklarata bankare e “Flatra Sh.p.k” për dhjetor 2017**

<b>Data</b>	<b>Përshkrimi</b>		<b>Pagesat</b>	<b>Depozita</b>	<b>Saldo</b>
			€	€	€
01/12/17	Saldo				11,001
02/12/17	Tarifat bankare		42		10,959
03/12/17	Çeku	4310	324		10,635
04/12/17	Çeku	4312	2,123		8,512
05/12/17	Depozitim			2,211	10,723
07/12/17	Çeku	4311	414		10,309
09/12/17	Çeku	4313	368		9,941
10/12/17	Energjia D.D.		1,028		8,913
11/12/17	Transfer kreditor			5,373	14,286
15/12/17	Tarifat bankare		160		14,126
16/12/17	Depozitim			543	14,669
18/12/17	Çeku	4315	186		14,483
20/12/17	T. Monika S.O.		102		14,381
21/12/17	124578			632	15,013
23/12/17	Depozitim			6,188	21,201
25/12/17	Çeku	4316	678		20,523
26/12/17	Meteor D.D.		425		20,098
28/12/17	Sigurimi S.O.		652		19,446
29/12/17	Transfer kreditor			3,457	22,903

Banka ka konfirmuar për ‘Flatra Sh.p.k” që ka bërë një gabim në llogarinë bankare të saj më 21 dhjetor 2017 duke depozituar shumën prej 632€ në llogarinë bankare të “Flatra Sh.p.k” edhe pse kjo shumë kishte të bënte me llogarinë e një klienti tjetër të bankës.

**Kërkohe:**

(a) Përgatisni një pasqyrë të harmonizimit bankar për "Flatra Sh.p.k" më 31 dhjetor 2017.

(16 Pikë)

(b) Diskutoni tri përfitimet nga përgatitja e pasqyrës së harmonizimit bankar .

(4 Pikë)

**[Total: 20 Pikë]**

## Zgjidhja e problemit 1

a)

Hapi 1: Harmonizoni saldon fillestare në librin e arkës dhe deklaratën bankare

Saldo e librit të arkës/Llogaria  
bankare- 01/12/2017 10,263

Shto zërat e pa debituar ende -

10,263

Saldo e ekstraktit bankar -  
01/12/2017 11,001

Heq çëçet e pa prezantuar

Çeku 4310 - 324

Çeku 4311 - 414

10,263

### Korrigjimet në

### Librin e arkës

#### Dhjetor

31 Saldo e pakorrigjuar 16,830

31 Çeku 4312 - Diferenca 90

31 Depozita - e pa  
regjistruar 3,457

31 Depozita (14/12/17) - Diferenca 9

20,386

#### Dhjetor

15 Tarifa bankare 160

31 Meteor D.D. 425

31 Sigurimi S.O. 652

Saldo e  
31 korrigjuar 19,149

20,386

**Harmonizimi i ekstraktit bankar**Saldo e pakorrigjuar nga ekstrakti bankar -  
31/12/2017**22,903**

Minus çëçet e pa prezentuara

Çeku 4314

618

Çeku 4317

488

Çeku 4318

6,884- **7,990**

Plus depozita e pa shlyer ende

Depozita - 30/12/2017

4,868 **4,868**

Gabimi i bankës

124578 - 21/12/2017

- 632- **632****Saldo e korrigjuar në bankë****19,149**

(b)

**Cilado nga tre të mëposhtmet :****Gabimet mund të identifikohen dhe korrighohen në një fazë të hershme****Zvogëlon rrezikun e mashtrimit dhe vjedhjes****Siguron që llogaria bankare në pasqyrat financiare të kompanisë është e saktë.****TOTAL PIKËT 20.00**

## Problemi 2

Glam Sh.p.k është e përfshirë në prodhimin e produkteve ndërtimore dhe pasqyrat e saj financiare janë si vijon :

### “Glam Sh.p.k” Pasqyra e Pozitës Financiare për vitin që përfundon më 31.12.2017

	2017	2016
	€'000	€'000
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>		
Prona, Impiante Pajisje	7,680	5,910
<b>Total Pasuritë jo-qarkulluese</b>	<b>7,680</b>	<b>5,910</b>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>		
Stoqet	2,070	1,830
Llogaritë e arkëtueshme	1,170	1,020
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët	75	168
<b>Total pasuritë qarkulluese</b>	<b>3,315</b>	<b>3,018</b>
<b>Total Pasuritë</b>	<b>10,995</b>	<b>8,928</b>
<b>Ekuiteti &amp; Detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali aksionar	360	300
Premia në aksione	90	75
Fitimet e mbajtura	5,697	3,603
Rezerva e rivlerësimit	180	120
<b>Total Ekuiteti</b>	<b>6,327</b>	<b>4,098</b>
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Huaja afatgjatë	2,250	2,400
<b>Total Detyrimet afatgjata</b>	<b>2,250</b>	<b>2,400</b>



**Detyrimet afatshkurtëra**

Llogaritë e pagueshme	2,208	2,250
Mbitërheqja bankare	60	90
Detyrimi për tatimin e pagueshëm	150	90
<b>Total Detyrimet afatshkurtëra</b>	<b>2,418</b>	<b>2,430</b>
<b>Total Ekuiteti &amp; Detyrimet</b>	<b>10,995</b>	<b>8,928</b>
	<hr/>	<hr/>

**Shënime:**

- (i) Fitimi para tatimit për vitin i "Glam Sh.p.k" është 2,243,000 €.
- (ii) Shpenzimet e tatimit në fitim për vitin 2017 ishin 63,000 €.
- (iii) Kosto e Pronës, Impianteve dhe Pajisjeve (PIP) më 1 Janar 2017 ishte 7,290,000 €. Politika e zhvlerësimit të kompanisë është të zhvlerësojë të gjitha pasuritë me 10% metoda drejtëvizore, në kosto, nga data e blerjes deri në datën e shitjes. Më 1 Tetor 2017, "Glam Sh.p.k" ka shitur PIP të cilat kishin vlerë neto në libra 520,000 €. Këto PIP kishin kosto historike 800,000 € dhe kompania krijoi një humbje nga shitja prej 20,000 €. Blerjet shtesë të PIP kanë ndodhur më 31 Dhjetor 2017.
- (iv) Kostot e financimit të "Glam Sh.p.k" kapin shumën prej 48,000 €. Ato u paguan plotësisht.
- (v) "Glam Sh.p.k" pagoi 86,000 € dividendë në vitin 2017.

**Kërkohet :**

Përgatisni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017 për "Glam Sh.p.k" sipas SNK 7 - *Pasqyra e rrjedhave të arkës*.

[Total: 20 pikë]

## Zgjidhja e problemit 2

**Glam Sh.p.k" Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017**

	€'000	€'000
<b>Rrjedha e P.G nga aktivitetet operative</b>		
Fitimi para Tatimit	2,243	
Shpenzimet e zhvlerësimit	709	
Humbja nga shitja e PIP	20	
Shpenzimet e interesit	48	
	<hr/>	
	3,020	
Rritja në stoque	- 240	
Rritja në LI/A	- 150	
Zvogëlimi në LI/P	- 42	
	<hr/>	
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet	2,588	
Interesi i paguar	- 48	
Tatimi i paguar	- 3	
	<hr/>	
<b>Rrjedha neto e P.G nga aktivitetet operative</b>		<b>2,537</b>
<b>Rrjedha e P.G nga aktivitetet investuese</b>		
Pagesa për blerjen e PIP	- 2,939	
Arkëtime nga shitja e PIP	500	
<b>Rrjedha neto e P.G nga aktivitetet investuese</b>		<b>- 2,439</b>
<b>Rrjedha e P.G nga aktivitetet financuese</b>		
Emetimi i aksioneve	75	
Pagesa e dividendës	- 86	
Pagesa për zvogëlimin e detyrimeve afatgjata	- 150	
	<hr/>	
	-	<b>161</b>
<b>Rrjedha neto e P.G dhe ekuivalentëve</b>		<b>- 63</b>
<b>P.G dhe ekuivalentët në fillim të vitit</b>	<b>Shënim 1</b>	<b>78</b>
<b>P.G dhe ekuivalentët në fund të vitit</b>	<b>Shënim 1</b>	<b>15</b>

Shënim 1	2017	2016
	€'000	€'000
Paraja e gatshme në dorë dhe në bankë	75	168
Mbitërheqja bankare	- 60	- 90
P.G dhe ekuivalentët	15	78
<b>TOTAL PIKË 20</b>		

Humbja nga shitja e PIP	€'000
Vlera neto në datën e shitjes	520
Çmimi i shitjes	500
<b>Humbja nga shitja e PIP</b>	<b>20</b>

#### Llogaria e Interesit

Saldo në fillim b/d	-	Shpenzimet e interesit - SOPL & OCI	48
Interesi i paguar	48	Saldo në fund c/d	-
	48		48

#### Llogaria e tatimit

Tatimi i paguar	3	Saldo në fillim b/d	90
Saldo në fund c/d	150	Shpenzimet - SOPL & OCI	63
	153		153

**Llogaria e kapitalit aksionar**

		Saldo në fillim b/d - Aksione	300
		Saldo në fillim b/d - Premia	75
Saldo në fund c/d - Aksione	360		
Saldo në fund c/d - Premia	90	Emetim i kapitalit aksionar	75
	<u>450</u>		<u>450</u>

**Llogaria për Prona, Impiante & Pajisje (PIP)**

Saldo në fillim b/d	5,910	Zhvlerësimi	709
Rezerva e rivlerësimit	60	Pasuria e shitur (VNL)	520
Blerja e PIP	2,939	Saldo në fund c/d	7,680
	<u>8,909</u>		<u>8,909</u>

### **Problemi 3**

Bilanci vërtetues në vijim është përgatitur nga librat e hotelit Atlantida , një hoteli me katër yje që ndodhet në hyrje të Mitrovicës, me të dhënat për vitin që mbaron më 30.08.2018:

<b>Përshkrimi i llogarisë</b>	<b>Shuma (në Euro)</b>
Shitjet	48,800
Blerjet	4,500
Rrogat	4,300
Objekti	252,000
Shpenzimet e gazetave	1,800
Kredia afatgjatë	157,000
Shpenzimet e interesit në kredi	12,200
Shpenzimet e telefonit	300
Llogaritë e arkëtueshme	1,400
Llogaritë e pagueshme	900
Furnizimet (Takëme dhe çarçafë)	1,400
Pajisjet (kostoja)	7,000
Zhvlerësimi i akumuluar, Pajisjet	1,400
Mobiljet	17,000
Zhvlerësimi i akumuluar, Mobiljet	8,800
Tërheqjet	18,800
Paraja	500
Banka (mbitërheqje)	3,600
Shpenzimet e energjisë	400
Shpenzimet e sigurimit	800
Shpenzimet e reklamës	500
Shpenzimet e përgjithshme	400
Stoqet fillestare	200
Kapitali	103,000

Duhet të përfshihen korrigjimet në vazhdim:

- a. Stoqet përfundimtare më 30 qershor 2018 ishin €100.
- b. Zhvlerësimi vjetor për ndërtesa llogaritet me shkallë prej 5% në baza drejtvizore.
- c. Zhvlerësimi vjetor për mobilje llogaritet me shkallë prej 40% sipas saldos zbritëse.
- d. Zhvlerësimi vjetor për pajisje llogaritet me shkallë prej 20 % në baza drejtvizore.
- e. Kishte një parapagim për sigurimin prej €150.
- f. Në shpenzimet e përgjithshme përfshihen edhe shpenzime të parapaguara prej €40. Shpenzime tjera akruale duhet të llogariten në lidhje me këto shpenzime në vlerë prej €150.
- g. Një faturë e energjisë (akruale) prej €150 ishte e papaguar.
- h. Shuma e borxheve (akruale) të gazetave ishte në vlerë prej €150.
- i. Takëme dhe çarçafët (furnizimet) ishin vlerësuar më 30 qershor 2018 me vlerë prej €1,250.
- j. Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë borxhe të këqija prej €200. Konsiderohet e nevojshme të bëhet një provizion/lejim shtesë për borxhet e dyshimta prej 10% të të arkëtueshmeve.
- k. Blerjet përfshijnë mallra me vlerë prej €350 që janë tërhequr për nevoja personale.
- l. Një faturë e telefonit (akruale) prej €120 ishte e papaguar.

**Kërkohet:**

Përgatitni Pasqyrën e të ardhurave dhe Bilancin e gjendjes për vitin që mbaron më 30.08.2018.

**[Totali: 20 Pikë]**

### Zgjidhja e problemit 3

#### a) Pasqyrat financiare

<b>Hoteli Atlantida</b>		
<b>Pasqyra e të ardhurave</b>		
<b>Për vitin që mbaron më 30 qershor 2001</b>		
Të hyrat nga shitje		48,800
Minus Kostoja e shitjeve:		
Stoqet fillestare	200	
Blerjet	<u>4,150</u>	
	4,350	
Minus Stoqet përfundimtare	<u>(100)</u>	<u>(4,250)</u>
<b>Fitimi bruto</b>		<b>44,550</b>
Minus Shpenzimet:		
Shpenzimet e rrogave	4,300	
Shpenzimet për furnizime (Takëme dhe çarçafë)	150	
Shpenzimet e reklamës	500	
Shpenzimet e telefonit	420	
Shpenzimet e përgjithshme	510	
Shpenzimet e borxheve të këqija	200	
Shpenzimet e borxheve të dyshimta	120	
Shpenzimet e energjisë	550	
Shpenzimet e sigurimit	650	
Shpenzimet e gazetave	1,950	
Shpenzimet e zhvlerësimit, Objektet	12,600	
Shpenzimet e zhvlerësimit, Mobiljet	3,280	
Shpenzimet e zhvlerësimit, Pajisjet	1,400	

Interesi në kredi	<u>12,200</u>	
		<u>(38,830)</u>
<b>Fitimi neto</b>		<u><b>5,720</b></u>

**Hoteli Atlantida**

**Bilanci i gjendjes**

**Më 30 qershor 2001**

<b>Pasuritë joqarkulluese</b>	<b>Kostoja</b>	<b>Zhvlerësimi i akumuluar</b>	<b>Vlera neto në libra</b>
Objekti	252,000	12,600	239,400
Pajisjet	7,000	2,800	4,200
Mobiljet	<u>17,000</u>	<u>12,080</u>	<u>4,920</u>
<b>Gjithsej pasuritë joqarkulluese</b>			<u><b>248,520</b></u>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>			
Stoqet		100	
Furnizimet (Takëme dhe çarçafë)		1,250	
Llogaritë e arkëtueshme		1,080	
Parapagimet		190	
Paraja		<u>500</u>	
<b>Gjithsej pasuritë qarkulluese</b>			<u><b>3,120</b></u>
<b>Gjithsej pasuritë</b>			<u><b>251,640</b></u>
<b>Kapitali dhe detyrimet</b>			
<b>Kapitali</b>			
Gjendja fillestare		103,000	
Fitimi neto i vitit		5,720	
Tërheqjet		<u>(19,150)</u>	
<b>Gjendja përfundimtare</b>			<u><b>89,570</b></u>



Detyrimet afatgjata			
Kredia afatgjatë		157,000	<u>157,000</u>
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme		900	
Shpenzimet akruale		570	
Mbitërheqja bankare		<u>3,600</u>	<u>5,070</u>
<i>Gjithsej detyrimet</i>			<u>162,070</u>
<b>Gjithsej kapitali dhe detyrimet</b>			<u>251,640</u>

## **Problemi 4**

Më 1 Janar 2017 Genta dhe Deti kanë blerë një franshizë 10 vjecare të një restoranti me emrin Pushimi sh.p.k dhe formuan një partneritet. Pushimi sh.p.k është franshizues i ri, me vetëm 3 lokacione tjera, për atë arsye vlera e franshizes ishte vetëm €20,000. Gjatë Janarit 2017, Genta dhe Deti morën me qira një ndërtesë të vjetër në qendër të qytetit. Gjatë Janarit dhe Shkurtit të dy pronarët kanë blerë mobilje dhe orendi me kosto €120,000, si dhe pajisje të kuzhinës me kosto €68,000. Mobiljet dhe orenditë ishin paguar me para të gatshme përderisa pajisjet e kuzhinës ishin blerë me afat pagese.

Gjatë Marsit, një punëtor i përgjithshëm ishte paguar €300 për montimin e mobiljeve dhe orendive dhe një elektrikist ishte paguar €800 që të instaloj pajisjet e kuzhines. Është konsultuar një kontabilist nga firma dhe janë marrë këto vendime sa i përket jetës së përdorimit, vlerës së mbetur, metodat e amortizimit dhe zhvlerësimit dhe politikën e amortizimit dhe zhvlerësimit.

Është dakorduar që regjistrimi i zhvlerësimit për mobilje dhe orendi si dhe pajisje të kuzhinës të bëhet vetëm për gjysmën e vitit.

Vlera e franshizës do të amortizohet për vitin e plotë të 2017.

	Jeta e përdorimit	Vlera e mbetur	Metoda
Franshiza	10 vite	€ 0	Drejtëvizore (Lineare)
Mobiljet dhe orenditë	10 vite	€ 5,000	Drejtëvizore (Lineare)
Pajisjet e kuzhinës	10 vite	€ 2,000	Metoda e saldës së zbritur (20%)

Restoranti u hap për klientë më 01 Prill 2017.

### **Kërkohet**

**a. Llogaritni koston totale me të cilën do të regjistrohen në librat e kontabilitetit të mëposhtmet:**

- i) Pajisjet e kuzhinës (2 pikë)**
- ii) Mobiljet dhe orenditë (2 pikë)**

**b. Përgatitni hyrjet për regjistrimin e dyfishtë për regjistrimin e amortizimit të franshizës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017. (3 pikë)**

c. Përgatitni hyrjet për regjistrimin në ditar të zhvlerësimit të mobiljeve dhe orendive për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017. (3 pikë)

d. Përgatitni hyrjet për regjistrimin në ditar të zhvlerësimit të pajisjeve të kuzhinës për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2017. (3 pikë)

e. Pas rishikimit të bilancit vërtetues, kontabilisti i kompanisë vendosi që vlera e franshizës është rritur. Kontabilisti vendosi se vlera e tregut të franshizës më 31 Dhjetor 2017 është €20,000.

Përgatitni hyrjet në ditar për të regjistruar rivlerësimin (ritjen e vlerës). (7 pikë)

( Totali 20 pikë)

#### Zgjidhja e problemit 4

a. i) Pajisjet e kuzhinës:  $68,000 + 800 = 68,800$

ii) Mobiliet:  $120,000 + 300 = €120,300$

b. D. Shp. e amortizimit – franshiza ..... 2,000

Kredi Amortizimi i akumuluar – franshiza ..... 2,000

$$(20,000 - 0) / 10 = 2,000$$

c. D. Shp. E Zhvlerësimit – mobiliet dhe orenditë ..... 5,765

Kredi Zhvlerësimi i akumuluar – mobiliet dhe orenditë ..... 5,765

$$(120,300 - 5,000) / 10 \times 0.5 = 5,765$$

d. D. Shp. e Zhvlerësimit – pajisjet e kuzhinës ..... 6,880

Kredi Zhvlerësimi i akumuluar – pajisjet e kuzhinës ..... 6,880

$$68,800 \times 0.2 \times 0.5 = 6,880$$

e. Debi Franshiza ..... 2,000

Kredi Rezerva e rivleresimit..... 2,000

$$20,000 - 2,000 = 18,000$$

$$20,000 - 18,000 = 2,000$$

## Problemi 5

Drafti i pasqyrave financiare të Kristit, kompani me përgjegjësi të kufizuara, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014 tregoi një fitim prej 86,000 €. Bilanci vërtetues nuk u barazua dhe përfshin një llogari pezull prej 3,310 € në kredi.

Gjatë kontrollimeve të mëpasshme, u gjetën gabimet në vijim:

- (a) Zhvlerësimi i mjeteve motorike për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014 prej 25 % është llogaritur me metodën e saldove zbritëse dhe është dashur të kalkulohet sipas metodës drejtvizore gjithashtu 25% .  
Shifrat përkatëse:  
Kosto e mjeteve motorike 120,000 €, vlera neto në libra më 1 Janar 2014, 88,000 €.
- (b) Qiraja e pranuar nga palët e treta për akomodim në zyre prej 1,200 €, ishte vënë në arkën e parave të vogla. Nuk u regjistrua as qeraja e arkëtueshme kur u arkëtua qiraja dhe nuk kishte pasur hyrje në librin e parave të vogla apo diku tjetër për të. Llogaria e arkës së parave të vogla në bilancin vërtetues sipas regjistrimeve të bëra tregon shumën prej 1,200 € më pak se sa shuma aktuale e parave e cila ndodhet realisht në arkë.
- (c) Borxhet e pakthyeshme prej 8,400 € duhet të fshihen plotësisht.
- (d) Saldo në fillim e llogarisë akruale për riparimet e mjeteve motorike të pagueshme prej 3,400 €, përfaqëson faturat e riparimit të pranuar por jo të paguara më 31 dhjetor 2013 dhe kjo saldo nuk ishte bartur më 1 Janar 2014.
- (e) Shuma e zbritjeve në para të gatshme për dhjetor 2014 nuk u postuan në llogaritë e zbritjeve në librin kryesor.

Shifrat ishin :

	€
Zbritja e lejuar	380
Zbritja e marrë	290

Pas korrigjimeve të nevojshme, llogaria pezull u balancua.

*Kërkohe*

Përgatisni hyrjet në ditar me shënimet përkatëse, për të korrigjuar gabimet e gjetura dhe përgatisni një pasqyrë ku tregoni ndryshimet të cilat kanë efekt në fitimin e vitit.

**20 pikë**

## Zgjidhja e problemit 5

### Hyrjet në ditar

	<i>Debi</i>	<i>Kredi</i>
	€	€
(a) Shpenzimet e zhvlerësimit – mjetet motorike (Ll) Zhvlerësimi i akumuluar – mjetet motorike	8,000	8,000
(b) Paratë e vogla Qiraja e arkëtueshme	1,200	1,200
(c) Shpenzimet e borxheve të qija Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve	8,400	8,400
(d) Llogatia pezull Riparimet e mjeteve motorike	3,400	3,400
(e) Zbritja e lejuar Zbritja e marrë Llogaria pezull	380	290 90

### Korrigjimi i fitimit

	€
Fitimi i pakorrigjuar	86,400
Zhvlerësimi	(8,000)
Të hyrat nga qiraja	1,200
Borxhi i keq i shlyer	(8,400)
Riparimet e mjeteve motorike	3,400
Zbritjet e lejuara	(380)
Zbritjet e marra	290
Fitimi neto i korrigjuar	<u>74,510</u>

**Shënim udhëzues:** Nuk ishte pjesë e kërkesës së detyrës të tregoni se si u mbyll llogaria pezull por është një kontroll i dobishëm të vërtetoni se korrigjimet e bëra në ditar në lidhje me llogarinë pezull janë të sakta.

### LLOGARIA PEZULL

	€		€
Riparimet e mjeteve motorike	3,400	Saldo në fillim	3,310
		Zbritjet	90
	<u>3,400</u>		<u>3,400</u>

### Llogaritjet

#### Korrigjimi i zhvlerësimit

	€
Sipas saldove zbritëse (88 x 25%)	22,000
Metoda drejtëvizore (120 x 25%)	30,000
Zhvlerësimi shtesë	<u>8,000</u>